

20160521297

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MENAXHIM ELEKTRONIK

Neni 1

Në Ligin për menaxhim elektronik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 105/2009, 47/11 dhe 193/15) në nenin 3 në paragrafin (1) pas alinesë 1 shtohet aline e re 2, si vijon:

"-SHËRBIMI PËR DËRGESË TË REKOMANDUAR ELEKTRONIKE TË DOKUMENTEVE është shërbim i cili mundëson bartjen e dokumenteve ndërmjet organeve reciprokisht, si dhe ndërmjet organeve dhe personave fizik dhe juridik në formë elektronike për mjedisit të vetëm për shkëmbimin e dokumentit dhe të dhënave në formë elektronike dhe siguron shërbim për nënshkrim elektronik dhe vulë elektronike, siguron provë lidhur me menaxhimin e dokumenteve bartëse, duke përfshirë edhe prova për dërgimin dhe pranimin e dokumenteve dhe i mbron dokumentet nga dëmtimi ose ndryshimet e palejueshme."

Neni 2

Titulli i nenit 31 dhe neni 31 ndryshohen si vijojnë:

"Neni 31

Mjedisi i vetëm për komunikim ndërmjet organeve në formë elektronike

(1) Shkëmbimi i dokumenteve dhe të dhënave ndërmjet organeve në formë elektronike bëhet drejtpërdrejt për mjedisit të vetëm për shkëmbimin e dokumenteve dhe të dhënave në formë elektronike.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, për organet të cilat nuk kanë mundësi për shkëmbim të drejtpërdrejtë të të dhënave dhe dokumenteve në formë elektronike, për komunikime me organe të tjera mund të shfrytëzohen shërbime për dërgesa të rekomanduara elektronike të dokumenteve për sistemeve të certifikuara të informatave.

(3) Mënyrën e komunikimit ndërmjet organeve në formë elektronike nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni e përcakton ministri i Shoqërisë informatike dhe administratës."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".